

UDHËZIM

Nr. 10, datë 22.05.2017

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 31. 03. 2017 "PËR
PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGARAMIT
PËR BUJQËSINE DHE ZHVILLIMIN RURAL"

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 4, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", neni 6, pika 3, të VKM nr. 137, datë 22.02.2017, "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural" për vitin 2017, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", dhe të udhëzimit nr. 19, datë 03.11.2014 "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar",

UDHËZIJMË:

Në udhëzimin Nr. 8, datë 31. 03. 2017 "Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", bëhen ndryshimet dhe shtesa:

1. Në aneksin 1, Harta e rajonizimit të skemave mbështetëse-2017, shtohet:

- Kultura e shegës në rrethin e Mirditës.
- Ujitja me pika në rrethet Kurbin, Mirditë dhe Mallakastër, Berat dhe Kuçovë.
- Të imtat në rrethin Kurbin.
- Lopë ekstensive në rrethin Delvinë.
- Akuakultura në rrethin Mirditë.
- Dorëzimi i midhjeve në rrethin Lezhë.
- Të imtat në rrethet Berat dhe Kuçovë.

dhe hiqet:

- Lopë ekstensive në rrethet Dibër, Bulqizë, Korçë, Kukës, Has, Tropojë dhe Vlorë.
2. Në aneksin 1.5, Harta e prodhimit të perimeve, patates, fasules, dorëzimi i të cilëve mbështet me financim, shtohet domatja në rrethin Delvinë si dhe Aplikimi për të gjitha kulturat perimore të kryhet vetëm për mbjelljet e dyta të cilat verifikohen në periudhën gusht-shtator.
3. Në aneksin 7, specifikimet teknike të serrave, pika 4 ndryshon dhe formulohet: “Sistemet e ngrohjes, ujitjes, ajrimit.
4. Në aneksi 2, numri i bimëve për ha sipas specieve:
 - *Helichrysum italicum* kultivohet vetëm për vaj dhe distancat e mbjelljes janë (70x30-40) cm duke siguruar mbi 35 000 bimë/ha.
 - Rozmarina kultivohet në distancat 1x1m, në fushë duke siguruar 10 000 bimë/ha dhe 0.8 x 0.8 m në tokat kodrinore duke siguruar mbi 15 000 bimë/ha.
5. Në aneksin 3 ndryshon rendimenti i patates në zonat malore dhe bëhet 200-230 kv/ha, dhe shtohet tek pemët frutore rendimenti i mjedrës 150-200 kv/ha.
6. Në masën “Përmirësimi i teknologjisë së mbjelljes së arrave, lajthive dhe bajameve,.... për kulturën e arrës tek Kriteret e përfitimit, pas pikës “I” shtohet pika “m)” dhe “n)” si vijon:
 - m) Subjekti aplikues të paraqesë faturën e cila specifikon/ tregon llojin e kultivarit dhe origjinën (autokton apo nga importi).
 - n) distancat e mbjelljes për varietet autoktone të jenë 7m x 7m dhe për varietet e importuara në distancat 5m x 5m.
7. Pika 3, gërma b, e masës ii, tek kriteret e përfitimit shtohet si vijon: Në rastin e luleshtrydhes përfitojnë aplikantët që realizojnë projektet (mbjelljet e reja) edhe në periudhën gusht-tetor.
8. Për çdo masë mbështetëse në “PROCEDURA QË DO TË NDIQET” periudha e aplikimit shtyhet deri në datën 16 qershor 2017.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

